

MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË

Ky Memorandum për Bashkëpunim të Ndërsjellë është lidhur më datë 05.06.2023 në mes të palëve si në vijim:

1. **UNI-Universum International College**, me numër unik identifikues 810640294 dhe me emër ligjor **Kolegji Universum O.P.**, me adresë të regjistruar në Rr. Hasan Prishtina 1.1, Konjuh, Lipjan, 14000 Kosovë, përfaqësuar nga ana e z. Alejtin Berisha - në cilësi të Përfaqësuesit të Autorizuar.

(në tekstin e mëtejshëm referuar si: **UNI**)

dhe

2. **KosInvest**, me numër të regjistrimit 5200150-1 me adresë Rr. Suterren, Llamella D, Arbëria 3, Nr. 01, 02, 03 10000 Prishtinë, Kosovë.

(në tekstin e mëtejshëm referuar si: **"KosInvest"**)

(në tekstin e mëtejshëm, së bashku referuar si: **"Palët"**).

1. Qëllimi i Memorandumit

- 1.1. Përmes këtij Memorandumi për Bashkëpunim, palët kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellë, me synim të ngritjes dhe zhvillimit të njohurive profesionale dhe akademike, si dhe ndërlidhjen e akademisë me biznesin, për studentët të cilët vijnë në studimet në UNI.

2. Fushëveprimtaria

- 2.1. Përmes këtij Memorandumi për Bashkëpunim, KosInvest do t'iu mundësojë studentëve të UNI praktikë profesionale dhe punë më orar të shkurtuar prej 20 orë në javë.
- 2.2. Studentët të cilët mund të angazhohen në praktikë profesionale dhe punë duhet të vijnë

studimet në këto programe/drejtime, të cilat ofrohen në kuadër të UNI:

- Biznes & Menaxhment
- Shkenca Kompjuterike
- Siguri Kibernetike
- Dizajn Grafik
- Gjuhë Angleze
- Gjuhë Gjermane
- Gazetari Dixhitale
- Juridik
- Shkenca Politike

2.3. Studentët të cilët angazhohen praktikë profesionale dhe në punë do të sistemohen në departamentet si në vijim:

- Kategori Menaxhment
- Operacione
- Financa
- Logjistikë
- Marketing
- IT
- Kalkulim
- Merchandising
- Kontabilist
- Financier
- Burime Njerëzore
- Ligjore
- Pozita të tjera sipas kërkesës së KosInvest

2.4. Numri i studentëve të cilët do të angazhohen në punë praktike përcaktohet nga menaxhmenti i KosInvest, me miratim të Uni - Universum International College

2.5. KosInvest do të nënshkruajë kontratë individuale me studentët të cilët angazhohen në praktikë profesionale dhe në punë. Këto kontrata do të përmbajnë të gjitha elementet e kontratës së punës të cilat parashihen sipas Ligjit të Punës.

2.6. Uni - Universum International College do të ofrojë ndihmë akademike me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të KosInvest

- 2.7. Sipas nevojës, në rast se Uni - Universum International College e sheh të arsyeshme, mund të ftojë stafin e KosInvest si lektorë mysafir në ligjeratat e ndryshme të cilat janë të ndërlidhura me punën të cilën e zhvillojnë stafi i KosInvest

3. Specifikat e bashkëpunimit

- 3.1. KosInves, sipas nevojës, do t'i dërgojë Uni - Universum International College (*Zyrës së Karrierës dhe Mirëqenies Studentore -ZKMS*) kërkesën për studentët e nevojshëm për t'u angazhuar në punë, me specifika mbi numrin e studentëve, departamentin, aftësitë e buta dhe ato teknike.
- 3.2. Uni - Universum International College do të sigurohet që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe sipas kërkesës së menaxhmentit të KosInvest, të dërguar në ZKMS të Uni - Universum International College.
- 3.3. Rekomandimi i kandidatëve për praktikë profesionale dhe punë do të bëhet nga Uni - Universum International College, përmes një komunikimi të rregullt dhe transparent me menaxhmentin e KosInvest
- 3.4. Uni - Universum International College dhe KosInvest do të dakordohen për përpilimin e një forme të vlerësimit për studentët të cilët angazhohen në punë. ZKMS, në kuadër të Uni - Universum International College, do të përpilojë raportin e vlerësimit i cili do të jetë i gatshëm për përdorim nga semestri vjeshtor i vitit akademik 2023/2024. Forma e vlerësimit duhet të dakordohet fillimisht në mes të KosInvest dhe Uni - Universum International College.
- 3.5. Mbikqyrësi/ja e studentit/es në KosInvest do të plotësojë raportin e vlerësimit në mënyrë elektronike në fund të çdo semestri. Ky raport më pas do t'i dërgohet Drejtorit të Departamentit përgjegjës në Uni - Universum International College.
- 3.6. Raporti i nxjerrë do të shqyrtohet nga Drejtori Akademik dhe do të përdoret për konsultim me profesorë dhe vlerësim në lëndë specifike, konform aftësive të zhvilluara gjatë punës. Sipas këtij raporti, studentët e angazhuar në punë do të mund të vlerësohen me pikë shtesë në lëndë specifike.
- 3.7. Në raste të mos-ardhjes apo mos-paraqitjes së studentit në praktikë profesionale dhe punë, KosInvest do të informojë Drejtorin e Departamentit përgjegjës dhe ZKMS.
- 3.8. KosInvest gëzon ekskluzivitet të plotë si Institucion Mikrofinanciar (duke përfshirë departamentet dhe njësitë e saj) në Memorandumin për Bashkëpunim me Uni - Universum International College.

4. Përdorimi i informatave/dokumentacionit dhe konfidencialiteti


- 4.1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna të shkëmbyera apo të pranuar sipas këtij Memorandumi për Bashkëpunim, do të përdoren me besueshmëri/konfidencialitet të plotë, vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum, dhe për komunikim të ndërsjellë.
- 4.2. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna të ndonjë palë, për qëllime të tjera jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e të njëjtit, pa aprovim paraprak të palës tjetër.

5. Dispozitat përfundimtare


- 5.1. Çdo mosmarrëveshje apo keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi për Bashkëpunim, palët do të tentojnë ta zgjidhin sipas procedurës së ndërmjetësimit. Në rast se palët nuk arrijnë t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre përmes ndërmjetësimit, atëherë, kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë.
- 5.2. Kohëzgjatja e këtij Memorandumi për Bashkëpunim është 1 vit, më saktësisht deri më datë 04.06.2024.
- 5.3. Ky Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
- 5.4. Ky Memorandum nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale, nga një për secilën palë.

Palët nënshkruese:


**Për UNI - Universum International
Colege:**



Data: 05.06.2023



Për KošInvest :



Data: 05.06.2023